



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM
PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESAVE ANKIMORE NR.06, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 28.05.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKTI: Për mospranimin për shqyrtim kërkesës ankimore Nr.06, datë 28.05.2019, të paraqitur nga subjekti ankues Partia Aleanca Demokratike me objekt: Kundërshtimi i vendimit nr.12, datë 23.05.2019 të KZAZ-së nr.08 Fushë-Arrëz "Per mosregjistrimin e listes shumemerore per keshillin e bashkise Fushe - Arrëz;

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa "b" dhe nenin 130 germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me nr. 06 regj, datë 28.05.2019.



Nr. 721 i Vendimit

Data 28.05.2019

Ora 19:00 e Vendimit

Për mos pranimin për shqyrtim të kërkesave ankimore nr. 06 të paraqitur në KQZ në datën 28.05.2019

Në mbledhjen e datës 28.05.2019, ora 19:00 pas relativitetit të z. Bledar Skënderi, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike kërkesa nr.06 u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe në mbështetje të nenit 129 pika 1, 3, germa "b", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesa Ankimore nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 129, pika 1, 3, germa (b) dhe nenin 130 germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.06, datë 28.05.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

